



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

Komuna e Prishtinës
Opština Priština – Municipality of Prishtina

01-678



Në bazë të nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, nenit 21, 44, 45 dhe 84 të Ligjit për Procedurën e Përgjithshme Administrative Nr. 05/L-03, dt.21.06.2016, nenit 17, pika "d" të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040 dt. 20.02.2008 dhe nenit 15 pika "d" e Statutit të Komunës së Prishtinës 01nr.110-391 dt.25.02.2010, Udhëzimit Administrativ të MMPH-së Nr.06/2017 dt. 23.05.2017, për caktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe të II-të të ndërtimeve, Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik 01nr.110-288305 dt.31.12.2014, dhe në bazë të kërkesës për kushte ndërtimore 05nr.350/02 - 87513/22 dt.21.04.2022, e kërkuesit / subjektit juridik, "Panda-T"sh.p.k. nga Prishtina me certifikate të biznesit ARBK 810806672 me pronare Taibe Fetiu nga Prishtina, për caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa afariste – ekonomike me **Karakter të përkohshëm** me destinim: **Kompleks i ndërtesave - punëtori për prodhimin dhe montimin e mjeteve piroteknike – fishekzjarrëve dhe ndërtesat përcjellëse**: Ndërtesa "1" – Administrata; Ndërtesa "2" – Kuzhina & gardëroba; Ndërtesa "3" – Depo e materialeve të lëndës së parë; Ndërtesa "4" – Depo e produktit final; Ndërtesa "5" – Prodhimi i fitilit për fishekzjarrë; Ndërtesa "6" – Përzierja e materialeve dhe Ndërtesa "7" – Depo e lëndës së parë, të gjitha me P+0, në kuadër të PZHK-së, konkretisht parcelës kadastrale nr.1156-1 ZK Vranidoll, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë për vendosjen e çështjes administrative, me datë 23.05.2022, merr këtë:

V E N D I M
CAKTIMI I KUSHTEVE NDËRTIMORE

I. I caktohen kushtet ndërtimore kërkuesit / subjektit juridik, "Panda-T"sh.p.k. nga Prishtina me certifikate të biznesit ARBK 810806672 me pronare Taibe Fetiu nga Prishtina, sipas kërkesës 05nr.350/02 - 87513/22 dt.21.04.2022, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesa afariste - ekonomike me **Karakter të përkohshëm** me destinim: **Kompleks i ndërtesave - punëtori për prodhimin dhe montimin e mjeteve piroteknike – fishekzjarrëve dhe ndërtesat përcjellëse**: Ndërtesa "1" – Administrata; Ndërtesa "2" – Kuzhina & gardëroba; Ndërtesa "3" – Depo e materialeve të lëndës së parë; Ndërtesa "4" – Depo e produktit final; Ndërtesa "5" – Prodhimi i fitilit për fishekzjarrë; Ndërtesa "6" – Përzierja e materialeve dhe Ndërtesa "7" – Depo e lëndës së parë, të gjitha me P+0, në kuadër të PZHK-së, konkretisht parcelës kadastrale nr.1156-1 ZK Vranidoll, sipas projekt propozimit konceptual dhe Plani i situacionit – "zgjidhja urbane".

II. Lokacioni për të cilën caktohen këto kushte ndërtimore, gjendet në kuadër të: *Planit Zhvillimor Komunal, miratuar me Vendimin e Kuvendit Komunal të Prishtinës, 01 nr. 031 – 156871 dt. 27.08.2013, ku sipas këtij plani kjo zonë është e planifikuar me destinim- zonë jo ndërtimore gjegjësisht zonë bujqësore, kurse kushtet ndërtimore për ndërtimin e kompleksit me objektet të lartcekura, caktohen bazuar në "Rregulloren për procedurën e ndërtimit të objekteve me karakter të përkohshëm në pronat e personave fizikë dhe juridik" miratuar me Vendimin e Kuvendin Komunal të Prishtinës, 01.nr.110-288305 dt.31.12.2014.*

III. Gjendja ekzistuese e lokacionit sipas: gjendjes kadastrale, pronësore, faktike & planifikimit urban është:

- Numri, sipërfaqja, pronari & klasa e kualitetit të parcelës kadastrale, janë:
- nr.1156-1; S=13,641m²; "Panda – T"sh.p.k.;....."Livadh i klasës 4" & "Tokë ndërtimore"

Totali: S=13,641m²

- Në kuadër të parcelës nr.1156-1 ZK Vranidoll nuk ka ndërtesa të ndërtuara – parcela është e zbrazët;

- Qasja aktuale e parcelës kadastrale është përmes rrugëve "Dafineti" dhe "Shpati";

- Tereni është relativisht i rrafshët, me një ramje të vogël nga drejtimi veri - jug;

IV. Kushtet ndërtimore për rregullimin e hapësirës sipas gjendjes së planifikuar, bazuar në kriteret dhe parametrat e rregullores që përcakton ajo, për realizimin - ndërtimin e Kompleksit me *Ndërtesë afariste & komerciale me Karakter të përkohshëm* dhe me destinim: Kompleks i ndërtesave - punëtori për prodhimin dhe montimin e mjeteve piroteknike - fishekzjarrëve dhe ndërtesat përcjellëse: Ndërtesa "1" – Administrata; Ndërtesa "2" – Kuzhina & gardëroba; Ndërtesa "3" – Depo e materialeve të lëndës së parë; Ndërtesa "4" – Depo e produktit final; Ndërtesa "5" – Prodhimi i fitilit për fishekzjarrë; Ndërtesa "6" – Përzierja e materialeve dhe Ndërtesa "7" – Depo e lëndës së parë, të gjitha me P+0, dhe hapësira tjera përcjellëse, janë:

- Organizimi & qasja në kompleks, pozicionimi, gabariti dhe etazhiteti i ndërtesave, raporti i ndërtesave me vijën rregulluese & ndërtimore, si dhe distancat nga kufiri i parcelës, rrugët dhe vend parkingjet e planifikuara të kompleksit, si dhe kushtet tjera për rregullimin e hapësirës, të jenë në tërësi sipas prezantimit grafik të përshkruar në Planin e lokacionit - "zgjidhja urbane" bashkangjitura vendimit kushteve ndërtimore;
- Qasja, hyrja - dalja në kompleks, sipas projekt propozimit është nga rruga përmes parcelës kadastrale nr.1156-2 dhe 1124-0 ZK Vranidoll si dhe pjesërisht nr.1156-1 ZK Vranidoll dhe lidhja e sajë me rr."Dafineti", duke i respektuar rregullat teknike për kyçe dhe me pëlqim përkatës nga organi kompetent;
- Koeficienti i shfrytëzimit i parcelës ndërtimore në kompleks (ISHP), për vendosjen e ndërtesës në bazë / gabarit të përdheses, lejohet max.40%, duke mos përfshi pjesën e parcelës me destinim aktual në hapësirë publike:
 $S=13,172 \times 0.4(40\%)=5,268.80m^2$ / sipas rregullores /
 $S=1,579.70m^2$ / sipas projekt propozimit /
- Dimensionet e ndërtesave të planifikuara, sipas projekt propozimit janë: Ndërtesa "1" – Administrata me dim.10.50 x 10.50m', Ndërtesa "2" – Kuzhina dhe gardëroba me dim.8.50 x 8.50m', Ndërtesa "3" – Depo e materialeve të lëndës së parë me dim. 20.5 x 20.50m', Ndërtesa "4" – Depo e produktit final me dim.20.50 x 20.50m', Ndërtesa "5" – Prodhimi i fitilit për fishekzjarrë me dim.20.6.0 x 4.60m', Ndërtesa "6" – Përzierja e materialeve me dim. 9.60 x 4.60m', Ndërtesa "7" – Depo e lëndës së parë me dim. 20.50 x 20.50m';
- Etazhiteti i ndërtesës dhe i strehës me përmbajtje: Kompleks i ndërtesave - punëtori për prodhimin dhe montimin e mjeteve piroteknike - fishekzjarrëve dhe ndërtesat përcjellëse: Ndërtesa "1" – Administrata; Ndërtesa "2" – Kuzhina & gardëroba; Ndërtesa "3" – Depo e materialeve të lëndës së parë; Ndërtesa "4" – Depo e produktit final; Ndërtesa "5" – Prodhimi i fitilit për fishekzjarrë; Ndërtesa "6" – Përzierja e materialeve dhe Ndërtesa "7" – Depo e lëndës së parë, të gjitha me P+0, me lartësi maksimale H=6.10m nga niveli i terrenit (sipas projekt propozimit konceptual);
- Kuota e nivelit të përdheses së objekteve nga niveli i terrenit – platos ose trotuarit të ndërtesës, mund të jetë max. 30cm;
- Ndërtesat me karakter të përkohshëm lejohen të ndërtohen nga materialet montuese dhe lehtë demontuese, si: hekuri, druri, plastika apo edhe ndonjë material i ngjashëm, dhe nuk lejohen elementet muratore dhe nga betoni për ndërtimin e objekteve (projekt propozimi është nga konstruksioni i hekurit dhe sendwiq panelet);
- Bazamenti i ndërtesës – themelet, mund të jenë nga betoni i armuar;
- Në ndërtesë nuk lejohet ndërtimi i etazheve nëntokësore;
- Distanca minimale e ndërtesës nga kufiri i parcelës fqinje të jetë 0.5 x H, është lartësia e ndërtesës. Kjo distancë mund të jetë deri në 120cm, me pëlqim të pronarëve të parcelave fqinje, kurse nëse në parcelat fqinje ndodhen objektet ekonomike, distanca mund të eliminohet me pëlqimin e pronarëve;
- Në kuadër të kompleksit të planifikohen hapësira me sipërfaqe gjelbëruese (ISGJ) me min.40% të sipërfaqes së parcelës ndërtimore, me gjelbërim të lartë & të ultë, dhe organizuara për sport & rekreacion, bazuar në paragrafin II. pika 2. të Vendimit 01nr.031 – 185481 dt.14.08.2015, të Kryetarit të Komunës së Prishtinës, dhe është:

$S=13,172 \times 0.4(40\%)=5,268.80m^2$ / sipas vendimit/

$S=8,520m^2$ / sipas projekt propozimit /

- Në kuadër të kompleksit të parashihet hapësira për vendosjen e mbeturinave;
- Gjatë punimeve ndërtimore duhet kujdes i veçantë në mbrojtjen e dobive natyrore.

V. Ndarja e parcelës kadastrale, nr. 1156-1 & 1156-2 ZK Vranidoll, do të realizohet sipas Parcelës ndërtimore, bazuar në Plani i situacionit – “zgjidhja urbane” dhe manuali i ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar.

Andaj, drejtorja jep PËLQIM për ndarjen e parcelave të lartcekura, sipas Planit të situacionit - “zgjidhja urbane” dhe manualit për bashkim. Procedura e ndarjes do të realizohet bazuar në pëlqimin e përshkruar në këtë paragraf, e cila do të shërbejë si bazë për regjistrimin në operetën kadastrale, të këtyre ndryshimeve, si dhe ndarja do realizohet para aplikimit për leje ndërtimore në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, me kërkesë të pronarit, si dhe bazuar në Plani i situacionit- “zgjidhja urbane” dhe Manualin e ndarjes punuar nga gjeometri i licencuar Ibrahim Junuzi nga Prishtina me numër të licencës nr.105, e të cilët janë pjesë përbërëse e këtij vendimi.

VI. Kusht i veçantë është prezantimi para aplikimit për leje ndërtimore, akti noterial “Deklaratë” e investitorit, “Panda – T” sh.p.k. nga Prishtina, me certifikate të biznesit ARBK 810806672 me pronare Taibe Fetiu nga Prishtina, me të cilin akt deklarohet me përgjegjësi të plotë penale dhe materiale se, është i vetëdijshëm për karakterin e përkohshëm të kompleksit ndërtimit dhe se do të bart të gjitha shpenzimet e demontimit të objektit si dhe kthimin në gjendje të mëparshëm të hapësirës, bazohet në rregulloren e objekteve me karakter të përkohshëm, konkretisht pikës 7 të rregullores.

VII. Kyçja në infrastrukturë - për marrjen e pëlqimeve nga KEDS-i dhe KUR “Prishtina” aplikimi do të bëhet nga kjo drejtori. Për aplikim nevojitet prezantimi i dokumentacionit, me përcaktim të vendeve për kyçje në rrjetet përkatëse, i dorëzuar veçantë në CD, me përmbajtje si në vijim:

- Emri (prindi) Mbiemri i aplikuesit dhe numri i identifikimit dhe adresa;
- Informatën mbi lokacionin - adresa e saktë e hapësirës ndërtuese;
- Kopjen e planit dhe certifikatën e njësisë kadastrale;
- Planin e situacionit (dispozita urbanistike pjesë përbërëse e kushteve ndërtimore) dhe pamjen në ortofoto të lokacionit me hapësirën ndërtuese;
- Përshkrimin teknik të objektit (destinimi dhe kapaciteti i nevojshëm për energji elektrike dhe ujësjellës).

Kyçja në infrastrukturë për ngrohje qendrore të bëhet në rrjetin ekzistues, pas sigurimit paraprak të kushteve detale dhe pëlqimit për kyçje nga “Termokos” - Ngrohtorja e Qytetit sh. dhe PTK-ja.

VIII. Hartimi i dokumentacionit ndërtimor / projekti kryesor, të bëhet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe me kualifikime përkatëse, duke u bazuar në kushtet ndërtimore të caktuara në pikën IV., projekt propozimin e prezantuar, normat dhe standardet në fuqi për këto lloje të objekteve, dhe të jenë në harmoni rregullativën ligjore në fuqi, dhe duhet të përmbaj:

- Lokacionin e parcelës ndërtimore në kuadër të zonës;
- Situacionin - Planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m', me ndërtesat ekzistuese dhe të planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin - Planin e lokacionit 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë, relative dhe absolute;
- Situacionin - “zgjidhja urbane” në përpjesë 1:200 ose 1:500, me dimensione të shënuara, horizontale dhe vertikale-kuota të lartësisë me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Incizimin gjeodezik të parcelës ndërtimore me rrethinë, si dhe me pozicionim të ndërtesave të projektuara dhe infrastrukturës rrugore, në sistemin koordinativ KOSOVAREF 01;
- Të gjitha bazat, prerjet dhe dukjet e fasadave, në përpjesë 1:50, për ndërtesat e projektuara, duke përfshirë edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese dhe etazheve tjera, me kuota të shënuara, relative dhe absolute;
- Përshkrimin teknik me paramasë dhe parallogari të punëve ndërtimore dhe ndërtimore-zejtare;
- Detajet e nevojshme, në përpjesë 1:5, 1:10 apo 1:20 dhe specifikimin e zdrukthëtarisë, me përshkrimin e materialit të dyerve dhe dritareve, në përpjesë 1:50;
- Projektin e organizimit të kompleksit, me rrugë, shtigje, mobiljarin urban, etj;
- Projektin e strukturës së ndërtimit-llogarinë statike, me përshkrim teknik, pozicionimin dhe detaje e nevojshme;
- Projektin e instalimeve elektro – energjetike, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin energjetik të qytetit dhe pozicionimin e trafostacionit;

- Projektin e instalimeve të ujësjellësit dhe kanalizimit, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Projektin e instalimeve të makinerisë, me përcaktimin e vendit për kyçje në rrjetin e qytetit;
- Elaborati i "Organizmi dhe masat e sigurisë në vend ndërtim", bazuar në Vendimin 01nr.035-174324 dt.12.07.2016, e Kryetarit të Komunës së Prishtinës;
- Elaboratin e fizikës ndërtimore dhe atë të mbrojtjes nga zhurma;
- Elaboratin gjeomekanik, në bazë të analizave të terrenit;

IX. Kushtet e veçanta - hartimi i dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor të ndërtesave të planifikuara, të bëhet në harmoni edhe me Ligji Nr. 03/L- 005 për Përdorimin Civil të Eksplozivëve, si dhe të sigurohet licenca përkatëse e paraparë sipas këtij ligji;

X. Dokumentacioni ndërtimor për Masat e mbrojtëse nga zjarri të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës. Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, dhe kërkesë të veçantë në Departamentin përkatës të Agjencisë së Menaxhimit të Emergjencave - AME, për sigurimin e rregullsisë së dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për Masat e mbrojtjes nga zjarri, për Kompleksin Karakter të përkohshëm dhe me destinim: Kompleks i ndërtesave - punëtori për prodhimin dhe montimin e mjeteve piroteknike – fishekzjarrëve dhe ndërtesat përcjellëse - Ndërtesa "1" – Administrata; Ndërtesa "2" – Kuzhina & gardëroba; Ndërtesa "3" – Depo e materialeve të lëndës së parë; Ndërtesa "4" – Depo e produktit final; Ndërtesa "5" – Prodhimi i fitilit për fishekzjarrë; Ndërtesa "6" – Përzierja e materialeve dhe Ndërtesa "7" – Depo e lëndës së parë, të gjitha me P+0me P+0; Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Planin e mbrojtjes nga zjarri-elaboratin, të hartuar nga kompani apo individ i licencuar;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Situacionin-planin e lokacionit, të gjerë në diametër prej 50m`, me ndërtesa ekzistuese dhe ndërtesat e planifikuara, në përpjesë 1:200, 1:500 apo 1:1000;
- Situacionin-"zgjdhja urbane" në përpjesë 1:200 ose 1:500, me pozicionim të ndërtesave në sistemin koordinativ KosovaREF01, duke përfshi edhe kuotat vertikale të hyrjeve në përdhese, me kuota relative dhe absolute;
- Kushtet ndërtimore, të caktuara nga Drejtoria e Urbanizmit (kopje);
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të investitorit dhe të hartuesit të planit të mbrojtjes nga zjarri.

XI. Dokumentacioni ndërtimor për Vlerësimin e ndikimit në Mjedis të hartohet nga ekipi me përgatitje të lartë profesionale dhe kualifikim përkatës, dhe aplikimi të bëhet në MMPHI- Departamenti për Mjedis dhe Ujëra, njëkohësisht me aplikimin për leje ndërtimore.

Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë dokumentacionin sipas Ligjit Nr.03/L-214 dt.29.10.2010 për Vlerësimin e ndikimit në mjedis;

XII. Marrëveshja për infrastrukturë – bazuar në nenin 23 të Ligjit Nr.04/L-110 për Ndërtim dhe në nenin 10 dhe 11 të "Rregullore mbi Taksën administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01–0094474/17 dt.24.04.2017, obligohet Drejtoria e Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave e Komunës së Prishtinës, të vlerësojë një ngarkesë për të ri-mbursuar koston për krijimin, përmirësimin, zgjerimin apo riparimin e infrastrukturës, dhe të arrijë marrëveshje për infrastrukturë me pronarin / investitorin.

Me aplikacionin për leje ndërtimore të dorëzohet dokumentacioni i nevojshëm, në dosje të veçantë, i cili përmes aktit përcjellës, do të procedohet, nga kjo drejtori, në kompetencë të Drejtorisë së Investimeve Kapitale dhe Menaxhimit të Kontratave të Komunës së Prishtinës, për arritjen e kësaj marrëveshjeje. Dokumentacioni i përgatitur duhet të përmbajë:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelën kadastrale/certifikatën e njësisë kadastrale dhe kopjen e planit (kopje);
- Vendimi për caktimin e kushtet ndërtimore, së bashku me situacionin e miratuar, të lëshuar nga kjo drejtori;
- Certifikatën e regjistrimit të biznesit të kompanisë investuese;
- Kontratën për bashkë investim (nëse është prezantuar në kërkesën për leje ndërtimore);
- Autorizimin për përfaqësim (nëse është prezantuar në kërkesën e lejes ndërtimore);
- Kopjen e letërnjoftimit të kërkuesit/ve (bashkëpronarëve të parcelave & investitorit);

XIII. Ndërrimi i destinimit të tokës bujqësore të kategoria "Livadh i klasës 4" të pjesës së parcelës kadastrale, nr.1156-1 ZK Vranidoll në tokë ndërtimore, bazuar në dispozitat ligjore të Ligjit mbi Tokën Bujqësore nr. 02/L-26 dt.24.06.2005 dhe Udhëzimit Administrativ nr. 41/2006, dt. 27.12.2006,

që rregullojnë këtë fushë, duhet të realizohet pas fuqizimit të kushteve ndërtimore dhe para aplikimit për leje ndërtimore në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, në departamentin përkatës të sajë.

Pasi për Planin Zhvillimor Komunal nuk është marrë pëlqim nga MBPZHR, për shndërrimin e tokave bujqësore në tokë ndërtimore, dhe parcela kadastrale nr. 1156-1 ZK Vranidoll përfshihet në PZHK, andaj procedura e ndërrimit të realizohet në Ministrinë e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, me aplikim dhe me pëlqimin paraprak nga kjo drejtori.

Sipërfaqja e tokës bujqësore, të cilës do ti ndërrohet destinimi, do të përcaktohet bazuar në sipërfaqen që do të ndërtohet, gjegjësisht parcelës ndërtimore përcaktuar sipas Plani i situacionit – "zgjidhja urbane", dhe e njëjta do të përfshijë sipërfaqen e parcelës ndërtimore, prej S=1,3172m² (pjesa e parcelës me destinim "Livadh i klasës 4"). Kjo sipërfaqe do të regjistrohet si tokë ndërtimore, në regjistrin kadastral, pas realizimit të pagesës së kompensimit për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore. Kompensimi - pagesa do të realizohet në Drejtorinë e Kadastrit të Komunës së Prishtinës, pas ndarjes së kësaj parcele dhe në fazën e zhvillimit të procedurës administrative për marrjen e lejes ndërtimore.

Gjithashtu pjesët e parcelës kadastrale nr.1156-1 dhe 1156-2 ZK Vranidoll, të destinuar për rrugë, do tu ndryshohet destinimi në "rrugë".

XIII. Pagesa e taksës administrative për leje ndërtimi, do të kalkulohet/realizohet sipas "Rregullore mbi Taksën Administrative për dhënien e lejes së ndërtimit dhe Tarifën për rregullimin e infrastrukturës" 01nr.434/01 – 0094474/17 dt.24.04.2017 dhe dokumentacionit ndërtimor / projektin kryesor, si pjesë përbërëse e kërkesës për leje ndërtimore. Pagesa e taksës administrative, sipas këtij paragrafi, do të realizohet sipas afatit kohor të përcaktuar në paragrafin 4 të nenit 16 të UA të MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017, pas marrjes së konfirmimit për pagesë.

XIV. Vlefshmëria e vendimit të kushteve ndërtimore është një(1) vit, me mundësi të vazhdimit për një(1) vit tjetër, në rastet kur nuk ka ndërruar gjendja ekzistuese, dokumenti i planifikimit hapësinor apo rregullativa ligjore në fuqi, dhe me aplikim para skadimit të afatit të vlefshmërisë.

A r s y e t i m

Kërkuesi / subjekti juridik "Panda-T"sh.p.k. nga Prishtina me certifikate të biznesit ARBK 810806672 dhe pronar Taibe Fetiu nga Prishtina, me kërkesën 05nr.350/02 - 87513/22 dt.21.04.2022 ka kërkuar nga kjo drejtori caktimin e kushteve ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, për ndërtimin e kompleksit me ndërtesa afariste – ekonomike me **Karakter të përkohshëm** dhe me destinim: **Kompleksi i ndërtesave - punëtori për prodhimin dhe montimin e mjeteve piroteknike - fishekzjarrëve dhe ndërtesat përcjellëse**: Ndërtesa "1" – Administrata; Ndërtesa "2" – Kuzhina & gardëroba; Ndërtesa "3" – Depo e materialeve të lëndës së parë; Ndërtesa "4" – Depo e produktit final; Ndërtesa "5" – Prodhimi i fitilit për fishekzjarrë; Ndërtesa "6" – Përzierja e materialeve dhe Ndërtesa "7" – Depo e lëndës së parë, të gjitha me P+0, në lokacionin e përkohshëm në paragrafin I. të dispozitivit të vendimit të kushteve ndërtimore.

Bashkangjitur me kërkesat: 05nr.351/05 – 249396/21 dt.17.11.2021, për plotësim dhe ndryshim të lejes ndërtimore, 05nr.351/05 – 249396/21/1 dt.14.04.2022 dhe për kushte ndërtimore 05nr.350/02 - 87513/22 dt.21.04.2022, shkresës "Plotësim dokumentacioni" 05nr.351/05 – 249396/21/2 dt.20.05.2022, si dhe gjatë fazës së trajtimit të kërkesës është prezantuar dhe trajtuar ky dokumentacion:

- Dëshminë mbi pronësinë për parcelat kadastrale nr.1156-1 & 1156-2 ZK Vranidoll, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër;
- Dëshminë mbi pronësinë për parcelat kadastrale nr. 1153-0 ZK Vranidoll, lëshuar nga Drejtoria për Kadastër;
- Afishja "Njoftim publik" i datave 27.04.2022 dhe 11.05.2022, lëshuar nga kjo drejtori;
- Fotokopja e pa vërtetuar e "Licencë për përdorimin e fishekzjarrëve" të dt.05.04.2018 dhe 19.07.2019 në emër të "Panda-T"sh.p.k. nga Prishtina;
- Shkresa "Informim dhe plotësim" 05nr.351/05 – 24939/21/1 dt.20.04.2022, lëshuar nga kjo drejtori;
- Fotokopja e pa vërtetuar e Vendim i lejes ndërtimore 05nr.351/02 – 236969/20 dt. 20.10.2021, lëshuar nga kjo drejtori;

- Fotokopja e pa vërtetua e Vendim i kushteve ndërtimore 05nr.350/02 – 69637/20 dt.07.08.2020, lëshuar nga kjo drejtori;
- Fotokopja e pa vërtetuar e "Listë distribuomi" nr.3739/2 dt.07.10.2020, lesuar nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural;
- Aktet noteriale, "Kontratë për shitblerje të paluajtëshmërisë" me LRP.nr.6378/2021 dhe Ref.nr.1035/2021 dt.11.11.2021, përpiluar te Noter Burim Z. Xhemajli në Prishtinë;
- Fotokopja e letërnjoftimit të Taibe Fetiut, Bajram Beqirit, Ramize Beqirit, Nexhmedin Musliut dhe Ibrahim Jonuzit;
- Certifikatë e Biznesit të "Panda-T"sh.p.k. nga Prishtina me ARBK 810806672 me pronare Taibe Fetiut;
- Certifikata – Deklaruesi i TVSH, të "Panda-T"sh.p.k. nga Prishtina me nr.330135097;
- Fotot e lokacionit dhe afishes së njoftimit publik;
- Incizimi gjeodezik i lokacionit punuar nga gjeodeti i licencuar Ibrahim Jonuzi nga Prishtina me licencë nr.105;
- Akti noterial "Autorizim gjeneral" përpiluar te Noter Burim Z. Xhemajli në Prishtinë me LRP.nr.470/2019 dt.20.02.2019, i dhen nga "Panda-T"sh.p.k. nga Prishtina për Nexhmedin Musliu;
- "Deklaratë" e posedueses e Vendim të lejes ndërtimore 05nr. 351/02-236969/20 dt.29.10.2021, Ramize Beqiri, përpiluar te Noter Burim Z. Xhemajli me LRP.nr.3261/2022 dt.19.05.2022;
- Projekt propozimi konceptual i kompleksit me ndërtesë afariste & ekonomike me **Karakter të përkohshëm** dhe me destinim: Punëtori për prodhimin dhe montimin e fishekzjarrëve: ÷ P+0, hartuar nga "Aspen Architecture"sh.p.k. nga Prishtina me ARBK 810842676, me projektues Dardan Metushi, M.ark dhe Arba Shushka, MSC.ark.;
- Fotot e lokacionit;
- Vërtetimi i obliguesit tatimor "Panda –T"sh.p.k., nr.79880/22 dt.12.04.2022;
- Vërtetimi i obliguesit tatimor "Panda –T"sh.p.k., nr.10-430/03-0249295/21 dt.17.11.2021;
- Shkresa Informim nga PZHK 04nr.350/01 – 57500/20 dt.11.03.2020, lëshuar nga DPSZHQ të Komunës së Prishtinës;
- Manuali i ndarjes së parcelave kadastrale nr.1156-1 & 1156-2 ZK Vranidoll, punuar nga gjeometri i licencuar Ibrahim Junuzi nga Prishtina me licencë nr.105.

Drejtoria e Urbanizmit pas pranimit të kërkesave: 05nr.351/05 – 249396/21 dt.17.11.2021, për plotësim dhe ndryshim të lejes ndërtimore, 05nr.351/05 – 249396/21/1 dt.14.04.2022 dhe për kushte ndërtimore 05nr.350/02 - 87513/22 dt.21.04.2022, shkresës "Plotësim dokumentacioni" 05nr.351/05 – 249396/21/2 dt.20.05.2022, të subjekti juridik "Panda - T"sh.p.k. nga Prishtina, konsultimit të dosjeve të lëndëve nga arkivi i drejtorisë për zonën në afërsi si dhe rregullativës ligjore në fuqi, konstatoi:

Kërkuesi - subjekti juridik "Panda-T"sh.p.k. nga Prishtina, bazuar kërkesën 05nr.350/02 – 69637/20 dt.13.05.2020 për kushte ndërtimore me Vendim 05nr.350/02-69637/20 dt.07.08.2020 është pajisur me kushte ndërtimore për hartimin e dokumentacionit ndërtimor / projektit kryesor për ndërtimin e kompleksit me tri (3) ndërtesa bujqësore – fermë e lopëve dhe një(1) ndërtesë për depo në shërbim të fermës me etazhitet P+0 në kuadër të PZHK-së, konkretisht parcelave kadastrale nr.252-0, 253-0 & 254-0 ZK Vranidoll. Gjithashtu, subjekti i njëjtë - "Panda - T"sh.p.k. nga Prishtina, bazuar në kërkesën për leje ndërtimi 05nr.351/02 – 236969/20 dt.28.12.2020 me Vendim 05nr. 351/02-236969/20 dt.29.10.2021 është pajisur me leje ndërtimi për ndërtimin e kompleksit me tri (3) ndërtesa bujqësore – fermë e lopëve dhe një (1) ndërtesë për depo në shërbim të fermës me etazhitet P+0 në kuadër të PZHK-së, konkretisht parcelës kadastrale nr.1153-0 ZK Vranidoll;

Subjekti juridik "Panda-T"sh.p.k. nga Prishtina, në fazën e zhvillimit të punimit të ndërtesave (dy (2) ndërtesa në pjesën veri-lindore të parcelës nr.1153-0 ZK Vranidoll), me kërkesën 05nr.351/05 – 249396/21 dt.17.11.2021 ka kërkuar nga kjo drejtori "Plotësim dhe ndryshim i lejes ndërtimore 05nr.351/02 – 236969/20", si dhe me kërkesën 05nr.351/05 – 249396/21/1 dt.14.04.2022 "Kërkesë për ndërhyrje në lëndë". Kjo drejtori pas shqyrtimit të këtyre kërkesave dhe përmbajtjes së tyre, përmes shkresës "Informim dhe plotësim kërkesë" 05nr.351/05 – 24939/21/1 dt.20.04.2022, ka kërkuar nga kërkuesi ndër të tjerash citojmë:

... "Drejtoria e Urbanizmit, pas pranimit dhe shqyrtimit të kërkesës 05nr.351/05-24939/21/1 dt.14.04.2022, dokumentacionit të prezantuar me kërkesë, konsultimit të rregullativës ligjore në fuqi, Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik 01nr.110-288305 dt. 31.12.2014, ka konstatuar se, se bazuar në natyrën

e kërkesës me numër të protokollit (05nr.351/05....) dhe numrat e protokollit për kushte ndërtimore (05nr.350/02.....), se numri i parë është për leje ndërtimi kurse kërkesa është për caktimin e kushteve ndërtimore, dhe njëherë duke pasur parasysh se parcelat përfshihen në kuadër të PZHK-së, andaj kërkojmë nga kërkuesi që të aplikoj për caktimin e kushteve ndërtimore, pra me numër të protokollit (05nr.350/02.....), ku njëherë dokumentacion i dorëzuar me kërkesën 05 nr. 351/05 - 24939/21/1 dt.14.04.2022, do të mbetet pjesë e kërkesës për kushte ndërtimore, gjithashtu kërkuessit me kërkesë duhet të prezantojnë edhe pëlqimin nga pronari i parcelës kadastrale nr.1156-2 ZK Vranidoll, në kuadër të së cilës parcelë me projekt propozim konceptual është planifikuar rruga për qasje në kompleks – parcelë kadastrale nr.1156-1 ZK Vranidoll”, përfundim i citatit, duke përcaktuar edhe afatin për plotësim prej 5 (pesë) ditës, andaj edhe kërkuesi përmes shkresës “Kërkesë për kushte ndërtimi” 05nr.350/02 – 87513/22 dt.21.04.2022, ka aplikuar për kushte ndërtimore.

Kjo drejtori pas pranimit të kërkesës për kushte ndërtimore, konkretisht në fazën fillestare të trajtimit të kërkesës, duke u bazuar në pikën 2 të nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt. 31.05.2012, me dt. 27.04.2022, ka vendos “Njoftim publik”, për lënien në dispozicion të publikut Projekt propozimin – “zgjidhja urbane” për dhënien e komenteve lidhur me pretendimet e kërkuessit, ku ky njoftim ka vazhduar të qëndrojë deri më dt.11.05.2022. Në këtë periudhë, në postën elektronike të zyrtarit përgjegjës, nuk ka arritur asnjë koment, që do të ishte interes apo kundërshtim të ndërtimit të kompleksit të kërkuar. Andaj, edhe është konstatuar se, janë plotësuar të gjitha kriteret fillestare të parapara ligjore për vazhdimin e trajtimit të kërkesës dhe caktimin e kushteve ndërtimore.

Në analizën e situacionit nga aspekti i komunikacionit dhe prezantuar në shkresën e zyrtarit – ekspertit për komunikacion, janë përcaktuar masat që duhet të ndërmerren, për organizimin e kompleksit si dhe kyçje të saj në rrugën nacionale, ku ndër të tjera konstatohet :

Pas shiqimit të propozimit të situacionit të zgjidhjes urbane të “Panda” shpk., ZK Vranidoll, Prishtinë, lidhur me kërkesën e kushteve ndërtimore të lëndës 05-351/05-249396/21/1 dt.14.04.2022, kyçja për automjete në rrugën ekzistuese “Shpati” në fshatin Vranidoll, sipas zgjidhjes urbane për objektet e përkohshme – Depo, me etazhitet P+0, mund të pranohet si e tillë. Kyçja duhet ti përshtatet teknikisht rrugës ekzistuese dhe të aplikohen kushtet e shikueshmërisë horizontale dhe vertikale në lokacionin e kyçjes dhe në kohën kur realizohet ajo.

Andaj, si konkludim përfundimtar, bazuar në konstatimet e më sipërme, dokumentacionin e prezantuar dhe shqyrtuar, konsultimin e rregullativës ligjore në fuqi, konkretisht nenit 21 të Ligjit për Planifikim Hapësinor Nr.04/L-174 dt.31.07.2013, nenit 18 të Ligjit për Ndërtim Nr. 04/L-110 dt.31.05.2012, nenit 13 të “Udhëzimi Administrativ i MMPH-së Nr.06/2017 dt.23.05.2017 për përcaktimin e procedurave për përgatitjen dhe shqyrtimin e kërkesave për kushte ndërtimore, leje ndërtimore dhe leje rrënimi për kategorinë e I-rë dhe II-të të ndërtimeve”, Rregullores për Procedurën e Ndërtimit të Objekteve me Karakter të Përkohshëm në Pronat e Personave Fizikë dhe Juridik 01nr.110-288305 dt.31.12.2014 për vendosje të çështjeve të planifikimit, ndërtimit dhe procedurës së përgjithshme administrative, si dhe në bazë të nenit 21, 44 & 45 të LPPA-së Nr.05/L - 031, lidhur me ligjshmërinë për caktimin e kushteve ndërtimore, Drejtoria e Urbanizmit vendosi që ta miratojë kërkesën për caktimin e kushteve ndërtimore, me faktet – provat e prezantuara, ta trajtojë sipas rregullativës ligjore në fuqi, me ç ‘rast konstatoi se kërkuesi ka prezantuar të gjithë dokumentacionin e nevojshëm, se projekt propozimi me planin e situacionit - “zgjidhja urbane” të prezantuar, është në harmoni me destinimin dhe kriteret tjera të rregullores për ndërtesa me karakter të përkohshëm, për caktimin e këtyre kushteve ndërtimore, kërkuessit / subjektit juridik, “Panda-T”sh.p.k. nga Prishtina, me certifikate të biznesit ARBK 810806672 dhe pronare Taibe Fetiu nga Prishtina, sipas kërkesë 05nr.350/02-87513/22 dt.21.04.2022, për hartimin e dokumentacionit ndërtimor/projektin kryesor, për ndërtimin e Kompleksit me ndërtesa afariste - ekonomike me **Karakter të përkohshëm** me destinim: **Kompleks i ndërtesave - punëtori për prodhimin dhe montimin e mjeteve piroteknike - fishekzjarrëve dhe ndërtesat përcjellëse**: Ndërtesa “1” – Administrata; Ndërtesa “2” – Kuzhina & gardëroba; Ndërtesa “3” – Depo e materialeve të lëndës së parë; Ndërtesa “4” – Depo e produktit final; Ndërtesa “5” – Prodhimi i fitilit për fishekzjarrë; Ndërtesa “6” – Përzierja e materialeve dhe Ndërtesa “7” – Depo e lëndës së parë, të gjitha me P+0, në kuadër të PZHK-së, konkretisht parcelës kadastrale nr.1156-1 ZK Vranidoll, sipas projekt propozimit konceptual dhe Plani i situacionit – “zgjidhja urbane”

Nga sa u cek më lartë u vendos si në dispozitiv të vendimit të kushteve ndërtimore.

Shtojcë: Plani i situacionit – “zgjidhja urbane” e Kompleksit me ndërtesa afariste me **Karakter të përkohshëm** me destinim: **Kompleks i ndërtesave - punëtori për prodhimin dhe montimin e mjeteve piroteknike - fishekzjarrëve dhe ndërtesat përcjellëse:** Ndërtesa “1” – Administrata; Ndërtesa “2” – Kuzhinë & gardëroba; Ndërtesa “3” – Depo e materialeve të lëndës së parë; Ndërtesa “4” – Depo e produktit final; Ndërtesa “5” – Prodhimi i fitilit për fishekzjarrë; Ndërtesa “6” – Përzierja e materialeve dhe Ndërtesa “7” – Depo e lëndës së parë të gjitha me P+0, në kuadër të PZHK-së, konkretisht parcelës kadastrale nr.1156-1 ZK Vranidoll, sipas projekt propozimit konceptual dhe Plani i situacionit – “zgjidhja urbane” dhe manuali i ndarjes, punuar nga gjeometri i licencuar Ibrahim Junuzi nga Prishtina me numër të licencës nr.105;

Udhëzim juridik: Pala e pakënaqur me vendimin e kushteve ndërtimore, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të këtyre kushteve ndërtimore. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MMPHI, Departamenti Ligjor i MMPHI-së.

I dërgohet përmes postës elektronike: Drejtorisë për Pronën, Drejtorisë për Kadastër, Drejtorisë për Investime Kapitale dhe Menaxhim të Kontratave, Drejtorisë për Planifikim Strategjik dhe Zhvillimit të Qëndrueshëm.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05NR.350/02 – 87513/21 DT. 23.05.2022**

Zyrtari:
Ergyn Hajredini,

U.D. Udhëheqëse e Sektorit:
Nazife Krasniqi,

Drejtori:
Arber Sadiki.





Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor / Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja / Ministry of Environment and Spatial Planning
AGJENCIA KADASTRALE E KOSOVËS / KATASTARSKA AGENCIJA KOSOVA / KOSOVA CADASTRAL AGENCY


Zyra kadastrale komunale / Opštinska katastarska kancelarija: Prishtinë Nr. i njësisë kadastrale / Br. katastarske jedinice: 1156-1,1556-2

Zona kadastrale / Katastarska zona: Vranidoll Numri i lëndës / Broj predmeta: 12/2022

Lloji i njësisë kadastrale / Vrsta katastarske jedinice: Parcel Shkalla e zvoglimit / Razmera plana 1:

Lista e koordinatave, kodit dhe përshkrimit të tyre / Lista koordinata, kod i njihov opis

Kosova-PRISHTINE		Zona Kadastrale: Vranidoll		Sistemi Koordinatave: SPOVOJASTRI	
Nr	Y	X	Lloji	Përshkrimi	Burimi
1	7514094.342	4737250.988	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
2	7514094.952	4737251.258	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
3	7514117.854	4737261.858	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
4	7514143.354	4737288.487	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
5	7514184.930	4737288.976	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
6	7514158.740	4737298.936	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
7	7514145.648	4737330.576	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
8	7514138.628	4737340.875	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
9	7514139.498	4737355.545	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
10	7514119.088	4737401.904	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
11	7514111.467	4737417.923	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
12	7514136.357	4737436.223	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
13	7514136.957	4737440.302	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
14	7514129.166	4737456.452	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
15	7514124.286	4737478.802	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
16	7514130.585	4737486.561	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
17	7514116.775	4737516.051	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
18	7514111.184	4737542.220	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
19	7514130.774	4737542.140	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
20	7514124.488	4737531.050	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
21	7514129.544	4737542.220	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
22	7514086.115	4737532.390	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
23	7514049.825	4737541.111	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
24	7514053.408	4737534.462	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
25	7514057.907	4737471.712	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
26	7514062.477	4737458.893	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
27	7514097.247	4737458.753	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
28	7514087.427	4737443.053	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
29	7514084.967	4737440.303	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
30	7514083.437	4737436.829	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
31	7514064.558	4737422.234	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
32	7514039.948	4737403.695	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
33	7514056.128	4737378.645	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
34	7514073.980	4737347.816	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
35	7514076.280	4737317.377	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
36	7514054.461	4737321.137	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
37	7514080.312	4737285.048	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
38	7514076.492	4737246.709	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
39	7514125.975	4737264.380	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
40	7514095.138	4737252.778	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
41	7514064.796	4737265.125	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
42	7514111.229	4737484.723	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
43	7514107.874	4737541.880	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
44	7514124.413	4737263.824	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
45	7514076.945	4737220.786	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
46	7514094.748	4737324.135	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
47	7514094.387	4737317.380	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
48	7514094.807	4737330.876	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
49	7514103.171	4737363.163	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
50	7514103.338	4737364.241	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
51	7514108.686	4737494.326	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
52	7514109.683	4737484.842	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
53	7514101.472	4737560.871	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
54	7514128.800	4737548.096	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
55	7514127.181	4737548.385	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
56	7514125.385	4737548.939	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
57	7514122.836	4737548.939	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
58	7514121.248	4737550.795	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
59	7514119.493	4737551.850	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
60	7514118.300	4737552.176	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
61	7514118.748	4737552.380	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
62	7514115.296	4737551.141	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
63	7514114.070	4737551.870	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
64	7514112.895	4737552.722	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
65	7514111.971	4737548.582	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
66	7514111.448	4737548.480	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
67	7514111.112	4737548.496	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
68	7514111.998	4737542.587	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
69	7514118.113	4737495.808	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
70	7514118.197	4737484.563	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
71	7514111.790	4737384.686	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
72	7514101.543	4737331.820	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
73	7514108.211	4737328.130	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
74	7514103.282	4737326.721	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
75	7514103.817	4737324.320	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
76	7514104.448	4737321.783	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	
77	7514101.678	4737286.300	2	Kurorë shprehëse metra të P&A	



Rilevoi / Snimio: Ibrahim Junuzi
(emri dhe mbiemri i geodetit kompanisë/ ime i prezime geodeta/ kompanje)

Nr. i licencës / Br. licence: 105

Nënshkrimi / Potpis:

Data e rilevimit / Datum snimanja: 10.05.2022



Aprovoi / Usvojio: _____
(emri dhe mbiemri i personit zyrtar/ ime i prezime shlybenog lica)

Nënshkrimi / Potpis: _____

Data e aprovimit / Datum usvajanja: _____



0,420 x 0,297 = 0,12 m²

TE GJITHA MASAT TE KONTROLOHENI DHE TE GRUASHENI NE KORRES NE PLANET TEGA, NEGA ANA E PUNES QE REALIZOHEN DHE NE QELIMET PUNARTEJTE DHE NE REZULTOHENI

Pemirësitja / Content: Merrëse e Përdorimit Projekt Mëso		Adresat / Location: Investitor / Client PARDALT shtet		Drejtimi / Application: Detyra Eshkall / Levels: P+0		Vendi / North:
Faza e Përdorimit / Purpose Phase: Projekt Mëso		Projektuar / Designed by: M.Arc. Blerina Matoshi, Msc.Arch. Anca Shusha		Data / Date: Prit 2022		
ASPHEN ARCHITECTURE s. r. r. Abdon Rada #100 Peshkopi P. + 383 45 600 750 e. info@aspen-architectur.com w. aspen-architectur.com		ASPHEN ARCHITECTURE Logo		Data / Date: Prit 2022		Formati / Format: A4/1
Projektuar / Designed by: M.Arc. Blerina Matoshi, Msc.Arch. Anca Shusha		Parat / Drawn by: Arca Blasi Blaqi		Projekti Nr. / Project Nr.:		Fleta Nr. / Page Nr.: